



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 208 prot., i AK, datë 28.03.2023, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të shoqërisë METRO FARMACI SHPK nga shoqëria DELTA HOLDING SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje Kuotash Kapitali”, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: DELTA HOLDING SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: themelimi, krijimi dhe administrimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to; blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen në korporata, partneritete apo shoqëri e sindikata me objekte aktivitete të ndryshme; blerja, barrësimi, hipotekimi apo transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme dhe titujve; konsulencë në fushën e investimeve të huaja dhe vendase etj.

Pala shitëse: Z. Dorian Sadiku, person fizik, shtetas shqiptar.

Shoqëria Target: METRO FARMACI SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtime civile të të gjitha llojeve; aktivitete në fushën e ndërtimeve civile, zbatime dhe projekttime, prodhime materiale inerte, gurë qeramikë etj; import, eksport, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve farmaceutikë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.